



AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORT VJETOR
JANAR - DHJETOR 2022

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje	3
1. Vlerësimi dhe Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtare.....	4
1.1. Kompensimi Financiar i Vendimeve Përfundimtare.....	5
1.2. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga Ndërtimet Informale (ALUIZNI)	8
2. Trajtimi i Kërkesave për Njohje Pronësie	9
3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i Fondit të Tokës për Kompensim.....	10
4. Çështje të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre	12
5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet	13
5.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015	13
5.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)	14
5.3. Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.	15
6. Kërkesa të depozituara pranë ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP	15
6.1. Kërkesa të depozituara në ATP.....	15
6.2. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës ATP	16
6.3. Ankesa të trajtuara të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes	17
6.4. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA	18
7. Analiza e Buxhetit dhe Fondeve Speciale të Kompensimit	19
7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2022 duke u bazuar në 12 mujor (i pa kuadruar nga dega e thesarit).....	19
7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për vitin 2022	20

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave si institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit Nr. 133/2015 “Për Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të Kompensimit të pronave” si dhe akteve nënligjore VKM nr.221/2016; VKM nr.222/2016 e ndryshuar me VKM nr.765/ 2017; VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766/2017 me VKM nr.1114/2020. ATP në zbatim të pikës 14 të VKM nr.221/2016, paraqet raportin vjetor për periudhën **Janar-Dhjetor 2022**. Ky raport reflekton punën e ATP-së gjatë vitit 2022 duke dhënë informacion për objektivat e arritura gjatë këtij viti.

Nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 133/2015 deri në **31 Dhjetor 2022**, ATP ka vijuar me Kompensimin Financiar dhe Fizik të vendimeve përfundimtare dhe **ka ekzekutuar 794 kërkesa** nga subjektet, **me vlerë financiare rreth 7.842 mld lekë** dhe ka shpërndarë fond fizik nga **fondi i tokës 713.2 ha**. Ndërsa për periudhën 10 vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit, ATP është e ngarkuar që të kryej ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që janë vlerësuar financiarisht sipas mënyrës dhe formave të përcaktuara në VKM-në 223/2016, të ndryshuar. ATP do të vijojë më tej me ekzekutimin e aplikimeve të administruara si dhe aplikimet e reja që do të vijnë sipas akteve nënligjore për vitet në vijim.

Për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie (*proces i përfunduar më 23.02.2019*) ATP ka proceduar pas përfundimit të afatit për kërkesat e patrajuara, mbështetur në pikën 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 133/2015, në të cilin citohet se: “Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t’i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji”.

Me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese **nr. 4 datë 15.02.2021**, i cili vendosi për shfuqizimin e disa pikave të Ligjit Nr. 133/2015, në ATP u pezullua procesi i Kompensimit Financiar të vendimeve përfundimtare dhe filloi puna për hartimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 133/2015 në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Me miratimin e Ligjit Nr. 77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” botuar në Fletoren Zyrtare në datë 15.12.2022, ATP-ja do të vijojë me ekzekutimin e vendimeve përfundimtare me të drejtë kompensimi për ato subjekte të cilët kanë aplikuar konform ligjit dhe me publikimin e regjistrit të vlerësimeve të vendimeve përfundimtare me të drejtë kompensimi për çdo rast kur ka ndryshuar zëri kadastal (në masën 10%).

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

1. Vlerësimi dhe Ekzekutimi Financiar i Vendimeve Përfundimtare

Agjencia e Trajtimit të Pronave nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 133/2015 deri në publikimin e fundit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 7, datë 23.02.2021 ka vlerësuar ***gjithsej 26 092 vendime*** përfundimtare për Kompensim të viteve 1993 – 2014, vlerësim prej të cilit rezultuan të dhënat si më poshtë:


- ▶ **18 734** vendime në total të vlerësuara;
- ▶ Vlera e vendimeve është **101,134,108.990** lekë;

Gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2022** Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar punën mbështetur në regjistrat e përditësuara të vendimeve përfundimtare për kompensim dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Janë përditësuar **15 vendime** që kanë njohur të drejtën e kompensimit si vijon:

- ▶ **9 vendime** janë të publikuara me vlerë pozitive;
- ▶ **2 vendime** janë hequr nga regjistri për shkak gabimi material;
- ▶ **2 vendime** janë për plotësim dokumentacioni nga subjekti;
- ▶ **2 vendime** janë me vlerë negative;

Të gjitha përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.



1.1. Kompensimi Financiar i Vendimeve Përfundimtare

Me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 15.02.2021, i cili vendosi për shfuqizimin e disa pikave të ligjit nr. 133/2015, në ATP u pezullua procesi i Kompensimit Financiar të vendimeve përfundimtare dhe filloi puna për hartimin e ndryshimeve të Ligjit Nr. 133/2015.

Pikat që janë marrë në konsideratë për tu ndryshuar janë në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4/2021 si dhe me rekomandimet e dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin Beshiri kundër Shqipërisë.

Ligji Nr. 77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” u botua në Fletoren Zyrtare nr. 168, datë 15.12.2022 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas botimit.

Theksojmë se gjatë periudhës së hartimit të ndryshimeve të ligjit, në ATP, Sektori i Kompensimit vijoi punën në zbatim të pikës 16/4 të VKM nr. 223/2016 e ndryshuar me VKM nr. 1114/2020, e cila u miratua si rekomandim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Beshiri kundër Shqipërisë, duke kryer përlllogaritjen e vendimeve që kanë njohur të drejtën e Kompensimit, bazuar me vlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual.

Sipas një **analize paraprake** rezulton që preken **rreth 4672 vendime** dhe do të përfitojnë një vlerë financiare **afërsisht 18,503,141,414.38 lekë**. Vendimet përfundimtare me vlerën e tyre përkatëse do të publikohen në Buletinin Zyrtar.

Gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2022**, ka vijuar puna lidhur me pranimin e aplikimeve të reja të reja për Kompensim Financiar, Fizik, Kompensimin me Kërkesë të Veçantë si dhe aplikimet për Ndërtimet Informale (ALUIZNI) nga të cilat:


- ▶ **24** aplikime janë për Kompensim Financiar, Fizik dhe me Kërkesë të Veçantë.
- ▶ **966** aplikime janë për Ndërtimet Informale (ALUIZNI) nga të cilat janë trajtuar **244** dosje.
- ▶ Vlera e shpërndarë për **244** dosjet e mësipërme është **553,856,429.85 lekë**.
- ▶ Në lidhje me kompensimin me Kërkesë të Veçantë janë trajtuar **209** dosje, ku janë lëvruar kështet e rradhës II, III, IV dhe V për aplikime të bëra ndër vite.
- ▶ Vlera e shpërndarë e kësteve të mësipërme është **694,530,663.72 lekë**.

Nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 133/2015 deri në 31 Dhjetor 2022, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ekzekutuar **794 vendime** me një vlerë prej **7,842,824,600.14 lekë** (*Vlera e Kompensimit Financiar plus vlera e llogaritur për Kompensim Financiar të Kërkesave të Veçanta*), nga të cilat **72 vendime** janë mbyllje procedimi, në periudhat si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar prej **1,826,870,845 lekë** (një vlerë prej **1,805,417,553 lekë** për Kompensim Financiar dhe një vlerë prej **21,453,292 lekë** për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar prej **2,056,845,314 lekë** (një vlerë prej **1,959,411,055 lekë** për Kompensim Financiar dhe një vlerë prej **97,434,259 lekë** për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta);

- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar prej **1,543,025,978.56 lekë** (një vlerë prej **35,521,553 lekë** për Kompensim Financiar dhe një vlerë prej **1 507 504 425, 56 lekë** për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar prej **1,282,427,619.21 lekë** (një vlerë prej **113,786,500.63 lekë** për Kompensim Financiar dhe një vlerë prej **1,168,641,118.58 lekë** për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar prej **855,099,341.17 lekë** (një vlerë prej **49,115,904.46 lekë** për Kompensim Financiar dhe një vlerë prej **805,983,436.71 lekë** për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2021** u shpërnda një fond për Kompensim Financiar me Kërkesë të Veçantë prej **278,555,501.76 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2022 u shpërnda** një fond për Kompensim Financiar me Kërkesë të Veçantë prej **694,530,663.72 lekë**

Paraqitje Grafike e Fondit Financiar të shpërndarë për periudhën 2016-2022




Nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 133/2015, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë nga Fondi Fizik i Pronave një sipërfaqe prej **713.22 Ha**, me një vlerë financiare prej **1,455,773,530.42 lekë**, si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një sipërfaqe prej **658,899 m² (65.9 Ha)** me një vlerë financiare prej **140,425,603 lekë**.

- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,575,064 m² (257.5 Ha)** me një vlerë financiare **522,796,506 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një sipërfaqe prej **568,909 m² (56.9 Ha)** me një vlerë financiare prej **11,6637,991 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,319,678.46 m² (231.97 Ha)** me një vlerë financiare prej **479,449,812.38 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një sipërfaqe prej **1,009,645.20 m² (100.96 Ha)** me një vlerë financiare prej **196,463,618.04 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2021 dhe 2022** nuk është shpërndarë sipërfaqe nga Fondi Fizik për shkak të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve në pritje të ndryshimeve të Ligjit Nr. 133/2015.


Paraqitje Grafike e Fondit Fizik të shpërndarë për periudhën 2016 – 2020



Tabelë përmbledhëse mbi procesin e kompensimit nga ATP për periudhën 2016 – 2022

Indikator ATP		Indikatorët në zbatim të ligjit 133/2015 për periudhën 2016-2022							Total 2016-2022
		2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
Kompensim Financiar /Fizik	Numri i vendimarrjeve	186	167	16	59	25	0	0	453
	Mbyllje procedimi	11	16	2	22	1	0	0	52
	Vlera e kompensimit (në lek)	1,805,417,553	1,959,411,055	35,521,553	113,786,500.63	49,115,904.46	0	0	3,963,252,566.09
	Sipërfaqe e kompensuar në (m ²)	658,899	2,575,064.98	568,909	2,319,678.46	1,009,645.20	0	0	7,132,196.64
Kompensim Financiar i Kërkesave të Veçanta	Numri i vendimarrjeve	4	12	86	86	75	6	0	269
	Mbyllje procedimi	0	0	4	11	5	0	0	20
	Vlera financiare e llogaritur	21,453,292	97,434,259	1,507,504,426	1,168,641,118.58	805,983,436.71	278,555,501.76	0	3,879,572,034.05
	Vlera financiare e shpërndarë	15,852,437	52,748,653	538,001,692	250,593,882.03	175,441,434.10	55,711,100.35	694,530,663.72	1,782,879,862.20
	Fondi i kursyer buxhetit të shtetit	70,416,155	251,197,331	3,010,751,267	1,808,648,168.82	1,252,744,470.90	417,833,252.64	0	6,811,590,663.36
TOTAL								794	7,842,824,600.14

Paraqitje grafike e fondit të kursyer buxhetit të shtetit nga Kompensimi me Kërkesa të Veçanta, pas miratimit të Ligjit Nr.133/2015 (2016-2022)



*Për vitin 2022, kursimi për buxhetin e shtetit është zero për arsye se ATP ka shpërndarë vetëm fond për këstet e rradhës të Kompensimit me Kërkesë të Veçantë, pra nuk ka pasur vendimarrje.

1.2. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga Ndërtimet Informale (ALUIZNI)

Lidhur me procesin e Kompensimit për pasuritë e zëna nga Ndërtimet Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronave, që prej vitit 2010 e në vijim, referuar VKM-së 383 datë 19/05/2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga Ndërtimet Informale”, të ndryshuar, ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesat për shpërndarjen apo lëvrimin e Fondit të Kompensimit për pronarët prona e të cilëve është prekur nga Ndërtimet Informale.

Që nga fillimi i këtij procesi dhe deri më tani, Këshilli i Ministrave ka miratuar shpërblimin e këtyre pronarëve nëpërmjet akteve normative, gjithsej ka publikuar 74 VKM dhe njëkohësisht ATP ka pranuar aplikimet për Kompensim dhe ka disbursuar deri në masën 70% të vlerës së miratuar për shpërblim nga Vendimet e Këshillit të Ministrave.

- ▶ Janë trajtuar gjithsej **244 dosje** dhe është shpërndarë një fond financiar prej **553,856,429.85 lekë**.

2. Trajtimi i Kërkesave për Njohje Pronësie

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të patrajuara (kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas Ligjit Nr. 133/2015). Gjatë periudhës 3 vjeçare të përcaktuar në ligj janë trajtuar me vendim **9 512** kërkesa.

Me përfundimin e afatit të Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka kryer njoftimin e subjektit kërkues (trashëgimtar ligjor/përfaqësues me prokurë), të tërheqë dokumentacionin e depozituar në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për **6950** kërkesa të patrajuara.

Gjatë periudhës **Janar 2022 – Dhjetor 2022** rezulton se pranë ATP-së, janë depozituar **135** kërkesa për tërheqje dokumentacioni tekniko/ligjor të dosjeve të administruara pranë ATP-së, të cilat nuk rezultojnë të trajtuara me vendim brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj.

Gjithashtu Sektori i Asistencës Ligjore, ka shqyrtuar kërkesat për informacion që janë depozituar pranë ATP-së nga subjektet kërkuese që kanë dosje të administruara pranë ATP-së, Avokatura e Shtetit, Gjykatat e Rretheve, si dhe institucionet e treta.

Për periudhën **Janar 2022- Dhjetor 2022** pranë Sektorit të Asistencës Ligjore janë depozituar dhe shqyrtuar kërkesat si më poshtë:

- ▶ Janë trajtuar **551 kërkesa zyrtare** të përcjella nga Gjykata e Tiranës si dhe ato të Rretheve, Avokatura e Shtetit, Avokaturat e Rretheve, Ministrinë e Linjës, ASHK-ja etj., të cilat kërkojnë informacione të ndryshme në lidhje me dosje/praktika të depozituara pranë gjykatave respektive për njohjen e pronësisë, për zona kadastrale të përcaktuara nëse kemi vendimmarrje ndër vite apo pretendime, si dhe kopje dokumentacioni.
- ▶ Janë trajtuar **117 kërkesa** në lidhje me vlerësimin dhe analizimin e dokumentacionit tekniko/ligjor, referuar kërkesë padive të përcjella dhe nga Gjykatat së Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit apo Avokatët e Shtetit në Nivel vendor etj.
- ▶ Janë trajtuar **109 kërkesa** qytetare të cilët kërkojnë informacione të ndryshme.
- ▶ Është kryer trajtimi i **85 kërkes/ankesave** të ardhura në portalin e-Albania si dhe posta elektronike e Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

3. Verifikimi, Identifikimi dhe Bllokimi i Fondit të Tokës për Kompensim.

Në zbatim të nenit 12, të Ligjit Nr. 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, Agjencisë së Trajtimit të Pronave i është vënë në dispozicion nëpërmjet VKM-së nr.770, datë 12.11.2014 “Për kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368,8 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësisive të qeverisjes vendore” dhe VKM-së nr.1077, datë 18.06.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor”, fondi fizik i tokës, që do të shërbejë për kompensimin fizik të ish-pronarëve, që disponojnë një vendim përfundimtar për njohje, me të drejtë për kompensimin e pronës dhe për të cilin ka një vlerësim financiar pozitiv të kryer nga ATP.

Informacioni për Fondin e Tokës Bujqësore të vënë në dispozicion të ATP-së, sipas VKM-së nr.770/2014 rezulton aktualisht si më poshtë paraqitur në formë tabelare:

NR.	GRUPIMI I PASURIVE	QARKU BERAT	QARKU ELBASAN	QARKU GJIROKASTËR	QARKU KORÇË
1	Totali i Nr.Pasurive pjesë e fondit	6253	4797	4200	8150
2	Nr.Pasurie të konfirmuara nga ZVRPP	5805	4010	3781	3938
3	Nr.Pasurie të konfirmuara nga BASHKIA	1012	1546	1657	256
4	Nr.Pasurie të pa informacion nga Bashkia ,ZVRPP	448	787	419	4212
5	Nr.Pasurie të informacion nga Bashkia	5241	3251	2543	7894
6	Nr.Pasurie të Verifikuara në terren nga ATP	6	258	67	7
7	Nr.Pasurie të ndara në më shumë se një pasuri sipas ZVRPP	44	137	96	52
8	Nr.Pasurie të dhëna për Komp fiz.me vendim ATP	22	236	28	38
9	Nr. Pasurie të rregj. nga subjek private sipas ZVRPP	88	111	54	44
10	Nr.Pasurie të dhëna me Qera sipas Bashkive	47	1	8	
11	Nr.Pasurie të ndara me AMTP sipas Bashkive	98	973	10	252
12	Nr.Pasurie në proces Legalizimi sipas ZVRPP				1
13	Nr.Pasurie të zëna me Ndërtime sipas ZVRPP		5		
14	Nr.Pasurie në proces Gjyqësor			2	

• FONDI FIZIK I TOKËS BUJQËSORE

SIPËFAQE TOTALE E FONDIT TOKË BUJQËSORE	SIPËFAQE TOTALE E SHPËRNDARË E FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE	SIPËFAQE TOTALE E MBETUR E FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE
23 368,80 HA	713,22 HA	22 655,58 HA

• **FONDI FIZIK I TOKAVE PYJORE DHE KULLOSORE**

GJITHSEJ FOND PYJOR E KULLOSOR (NË HA) SIPAS VKM NR.1077, DATË 18.06.2008	GJITHSEJ FOND PYJOR E KULLOSOR (NË HA) SIPAS KORESPONDENCËS ME MINISTRINË E MJEDISIT	DIFERENCA E SIPËFAQES TOTALE E MBETUR E FONDIT TË TOKËS BUJQËSORE
71 699,30 HA	50 989,76 HA	20 709,54 HA

• **FONDI FIZIK I OBJEKTEVE SHETËTËRORE TË PA PRIVATIZUARA**

Nr.	Qarku	Rrethi	Numri i Objekteve
1	Berat	Berat	3
2	Berat	Poliçan	1
3	Dibër	Bulqizë	13
4	Dibër	Dibër	19
5	Dibër	Klos	1
6	Dibër	Mat	4
7	Durrës	Durrës	5
8	Durrës	Krujë	4
9	Durrës	Fushë-Krujë	1
10	Elbasan	Elbasan	3
11	Elbasan	Gramsh	1
12	Elbasan	Librazhd	3
13	Fier	Fier	10
14	Fier	Lushnjë	2
15	Gjirokastër	Dropull	2
16	Gjirokastër	Gjirokastër	2
17	Gjirokastër	Memaliaj	1
18	Gjirokastër	Përmet	2
19	Gjirokastër	Tepelenë	12
20	Korçë	Devoll	1
21	Korçë	Kolonjë	2
22	Korçë	Korçë	14
23	Korçë	Pogradec	7
24	Kukës	Has	12
25	Kukës	Kukës	10
26	Kukës	Tropojë	11

27	Lezhë	Kurbin	4
28	Lezhë	Lezhë	1
29	Lezhë	Mirditë	12
30	Shkodër	Malësi e Madhe	1
31	Shkodër	Pukë	3
32	Shkodër	Shkodër	3
33	Shkodër	Vau i Dejës	2
34	Vlorë	Delvinë	1
35	Vlorë	Sarandë	3
36	Vlorë	Vlorë	5
TOTAL			181

FONDI FIZIK I OBJEKTEVE SHETËRORE TË ALBMINIERËS

Nr.	Qarku	Rrethi	Numri i Objekteve
1	Dibër	Bulqizë	10
2	Dibër	Burrel	4
3	Dibër	Peshkopi	1
4	Gjirokastër	Memaliaj	11
5	Lezhë	Rubik	6
TOTALI			32

ATP-ja ka bërë korrespondencë me Agjencitë Shtetërore të Kadastrës për sa i përket statusit juridik të pasurive të evidentuara nga Fondi i Tokës Bujqësore dhe Fondi Pyjor- Kullosor, si dhe ka kryer diskutime mbi procesin e kalimit në favor të ATP-së të tokës Pyjore- Kullosore për t'u përdorur si Fond Kompensimi Fizik.

4. Çështje të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre

ATP për periudhën *Janar - Dhjetor 2022* është përfaqësuar në dy shkallët e gjyqësorit, civil dhe në atë administrativ, për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, si vijon:

Për këtë periudhë në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor janë depozituar **471 padi** në të gjitha Gjykatat e Rretheve, në Gjykatat e Apelit, në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe në Apelin Administrativ.

► Gjatë kësaj periudhe janë mbyllur me vendim **465** çështje nga ku:

- Janë pranuar **31 padi**.
- Janë rrëzuar **140 padi**.
- Kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e çështjes **152 padi**.
- Janë ushtruar **86 ankime** dhe **75 rekurse**.

- Në lidhje me vendimarrjen e ATP-së sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të **nenit 29** të Ligjit Nr. 133/2012 rezulton se janë depozituar **7 padi** dhe **rrëzuar 3 padi**.

- Në lidhje me kundërshtimin e vlerësimeve financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e Kompensimit parashikuar në **nenin 19** të ligjit janë depozituar **8 padi** dhe janë **rrëzuar 3 padi**.

- Në lidhje me vlerësimin financiar të vendimeve që kanë njohur të drejtën e Kompensimit parashikuar në **nenin 15** të ligjit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë depozituar **27 padi**.

Në lidhje me njohjen e të drejtës së pronësisë parashikuar në **nenin 34** të ligjit në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile janë depozituar **179 padi**.

5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet.

Agjencia e Trajtit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe Kompensimit të Pronës, bashkërendon veprimtarinë kryesisht me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

5.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, siç vijon:

- Analizë e veprimtarisë së ATP-së për periudhën Janar - Dhjetor 2021 si dhe prioritetet dhe objektivat për vitin 2022.

- ▶ Raporte periodike 3 mujor, 6 mujor dhe vjetor institucional për vitin 2021 mbi veprimtarinë e ATP-së pranë Ministrisë së Drejtësisë, Kryeministrisë dhe Komisioneve Parlamentare në zbatim të ligjit 133/2015.
- ▶ Kontributi i parë dhe i dytë institucional për hartimin e Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2022.
- ▶ Kontributi i ATP-së mbi takimin e 12-të të Komitetit të Stabilizim Asocimit Bashkimi Evropian-Shqipëri.
- ▶ Raportim 3-mujor mbi Planin e masave për rekomandimet e Progres Raportit të vitit 2021, në lidhje me Kapitullin 23 për zyrën e Kryenegociatorit.
- ▶ Kontributi i ATP-së mbi monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, raportim periodik 3 mujor, 6 mujor dhe vjetor.
- ▶ Kontributi i ATP-së mbi përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 për nënfushën “Çështjet e Pronësisë”.
- ▶ Përditësim mbi procedurat dhe kontributin e ATP-së në takimet e “Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori të Drejtat Themelore”.
- ▶ Raport mbi progresin në hartimin e Planit të Integritetit sipas Metodologjisë së Riskut të Integritetit pranë Ministrisë së Drejtësisë për 6M1-2022.
- ▶ Raportime periodike mujore pranë ZOS-it (Zyra Operacionale Situatës në Kryeministri) për indikatorët E-shërbime ndaj qytetarëve si dhe indikatorët skanim/hartografime.

5.2. Raportime periodike mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)

Evidencë e raportimeve periodike mujore pranë ZOS për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Indikatori	3M1	3 M2	3M3	3M4	TOTALI
Aplikime të plota	1200	1094	320	446	3060
Aplikime të paplota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Aplikime të mbartura	464	451	127	187	1229
Total i shërbimeve të lëvruara	335	217	111	168	831
Shërbime të lëvruara brenda afatit	358	202	101	157	818
Shërbime të lëvruara jashtë afatit	27	15	10	11	63
Plotësim dokumentacioni	0	3	2	3	8
Ankesa të reja	5	0	0	0	5
Ankesa të mbartura	24	24	24	24	24
Numri total i ankesave të zgjidhura/shqyrtuara	3	0	0	0	3
Nr.ankesash të zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	3	0	0	0	3
Nr.ankesash të zgjidhura/shqyrtuara jashtë afatit	2	0	0	0	2
Aplikime për Kompensim nga ALUIZNI	389	418	75	86	966
Aplikime për Kërkesa të Veçanta	4	0	3	1	8

Aplikime për Kompensimim Financiar dhe Fizik	8	5	2	1	16
Aplikime për shërbime pa vendimmarrje	799	671	240	358	2068

5.3. Raportime periodike mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2022**, skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis rezulton:

- ▶ **138** është numri i vendimeve në dosjet e skanuara:
- ▶ **508** është numri i vendimeve të hartografuara:

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna me skanimin e dokumenteve plotësuese të vendimeve të skanuara më parë, që dalin gjatë procesit të punës, si proces verbale të dosjeve të tërhequra nga subjektet, praktika të tërhequra nga subjektet si dhe vendime të Gjykatës të depozituara me Memo në dosje dhe praktika.

6. Kërkesa të depozituara pranë ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP

6.1. Kërkesa të depozituara në ATP

Për periudhën **Janar - Dhjetor 2022** pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave në lidhje me shërbimet që ofrohen, janë trajtuar:

➤ **Nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese:**

- ▶ numri i shkresave hyrëse qytetare **2165**
- ▶ numri i shkresave hyrëse zyrtare **6486**
- ▶ numri i shkresave me përgjigje qytetare **1966**
- ▶ numri shkresave me përgjigje zyrtare **2874**

Diferenca e krijuar ndërmjet numrit të shkresa hyrëse dhe dalëse krijohet si rezultat i shkresave të cilat nuk kërkojnë përgjigje si : fletëthirrje, rekurse dhe ankime të palëve ndërgjyquese për efekt njoftimi në ATP, rrëzim padie, pushim gjykimi, kërkesa depozitim dokumentacioni nga subjektet etj.

Evidencë e trajtimit të shkresave nga zyra e protokollit Janar - Dhjetor 2022 sipas 3 mujorëve.

Indikatoret	Treguesit statistikor	Periudha e raportimit				
		3M1	3M2	3M3	3M4	TOTAL
Trajtimi i shkresave në ATP, numri i shkresave hyrëse dhe të trajtuara me përgjigje	Numri i shkresave hyrëse qytetare	764	663	193	545	2165
	Numri i shkresave hyrëse zyrtare	1770	2032	970	1714	6486
	Numri i shkresave me përgjigje qytetare	545	824	241	356	1966
	Numri shkresave me përgjigje zyrtare	803	903	399	769	2874

➤ Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun për periudhën **Janar - Mars 2022** janë depozituar **268 kërkesa qytetare**, nga të cilat rezultojnë:

- ▶ Kërkesë për tërheqje dokumentacioni: **64**
- ▶ Kërkesë për plotësim dokumentacioni: **159**
- ▶ Kërkesë për informacion: **9**
- ▶ Ankesë: **2**
- ▶ Kërkesë për vërtetim page: **4**
- ▶ Kërkesë për kopje dokumentacioni: **31**

Spektori i Marrëdhënieve me Publikun, Mediat dhe Shërbimin Online ka kryer 77 njoftime për tërheqje kopje dokumentacioni të kërkuara nga subjektet.

Shërbimet në sportelet e ATP-së janë ndërprerë në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020".

6.2 Dokumente të trajtuar nga sektori i Arkivës

Në arkivën e ATP-së për periudhën **Janar - Dhjetor 2022** rezulton se:

Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **611 dosje** dhe praktika të cilat kanë zbritur në arkiv nga sektorët dhe janë hedhur në sistemin Web-GIS, të detajuara si vijon:

- ▶ **277** aplikime zyrtare
- ▶ **72** aplikime të depozituara nga qytetarët
- ▶ **262** aplikime në e-Albania

Janë realizuar përgjigjet e **596 aplikimeve**, nga të cilat:

- ▶ **276** aplikime zyrtare
- ▶ **70** aplikime të depozituara nga qytetarët
- ▶ **250** aplikime në e-Albania

Janë administruar dhe përpunuar **321 dosje të tërhequra**, **13 dosje** në mbështetje të nenit 22, **27 praktika** të cilat kanë zbritur në Arkivë nga ish Sektori i Shqyrtimit dhe **11 dosje** aplikimi për Kompensim nga Sektori i Kompensimit.

Janë skanuar proces verbalet, kthim përgjigjet (të dosjeve dhe praktikave të pahedhura dhe të paqarta), vendimet e Gjykatës të depozituara me Memo si dhe plotësime të skanimeve ekzistuese që dalin gjatë procesit të punës të **618 dosjeve**, **4 Memo** dhe **29 kthim përgjigje**.

Janë trajtuar me përgjigje **865 kërkesa** të adresuara Sektorit të Arkivës nga institucionet dhe qytetarët.

Janë trajtuar me përgjigje **113 kërkesa** nga institucionet dhe qytetarët në sistemin on-line SQDNE, AMS, Platforma Bashkëqeverisjes.

Është realizuar vendosja në dispozicion të dokumentacionit që kërkohet me e-mail zyrtar nga sektorët e tjerë të ATP-së.

Janë vënë në dispozicion **119 kopje të vendimeve** të Kompensimit grupit të punës ngritur me Urdhër të Ministrit Nr. 66 datë 17.02.2022.

Në zbatimin të Urdhrit nr.15, datë 25.02.2022 “Për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës të Vlerës së Ruajtjes të Dokumenteve të Agjencisë së Trajtimit të Pronave” u hartua dhe u miratua Rregullorja nr. 35 datë 07.04.2022 e Komisionit të Ekspertizës dhe në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve të ATP-së u hartua dhe miratua lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave.

Në zbatim të neneve 42, 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 dhe pas miratimit të listës konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave të ATP-së po punohet në vazhdimësi për përpunimin e dokumentave administrative.

6.3 Ankesa të trajtuara të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2022 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

Për periudhën **Janar – Dhjetor 2022** nga kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe i denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave nga Grupi i Punës Anti Korrupsion është raportuar, si vijon:

- ▶ Në ATP është 0 (zero) numri i raporteve dhe inspektimeve nga Grupi i Inspektimit të ATP-së;
- ▶ Nuk ka patur asnje raportim dhe për këtë arsye nuk është bërë asnje inspektim dhe nuk është marrë asnjë masë;
- ▶ Nuk ka asnjë rast të referuar në Prokurori.

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesa/ankesa të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Nga Janari deri në Dhjetor 2022, janë trajtuar me përgjigje **139 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, nga të cilat:

- ▶ **59** kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e Kompensimit Financiar/Fizik.
- ▶ **10** kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimmarrjes për Njohjen e Pronësisë.
- ▶ **36** kërkesë/ankesë të cilat kanë lidhje me procesin e shqyrtimit të kërkesave për Kompensimin në vlerë të subjekteve, tokat e të cilëve janë zënë me Ndërtime Informale (ALUIZNI).
- ▶ **29** kërkesë/ankesa për Sektorin e Protokollit/Arkivës/Mardhënieve me Publikun.
- ▶ **4** kërkesë/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor.
- ▶ **1** kërkesë/ankesë për Sektorin e Verifikimit të Kërkesave.

Nr	Indikatori	3M1	3M2	3M3	3M4	Total 2022
1	Kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e Kompensimit Financiar/Fizik	14	10	15	20	59
2	Kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me Sektorin e Asistencës Ligjore	1	3	1	5	10
3	Kërkesë/ankesa të cilat lidhen me procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensim në vlerë të subjekteve ,tokat e të cilëve janë zënë nga Ndërtimet Informale (ALUIZNI)	5	12	6	13	36
4	Kërkesë/ankesë për Sektorin e Arkivës/Protokollit/Marrëdhënieve me Publikun	12	10	1	6	29
5	Kërkesë/Ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor	2	1		1	4
6	Kërkesë/Ankesë për Sektorin e Verifikimit të Kërkesave				1	1

6.4 Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e dy shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, nga ATP-ja ka vijuar puna me shërbimet elektronike të bëra publike.

Për vitin 2022 nëpërmjet portalit e-Albania janë paraqitur **532 aplikime** nga të cilat:

- ▶ **353 aplikime -Ankesë** dhe trajtimi i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP-së.
- ▶ **197 aplikime -Kërkesë** për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes.

Në sistemin e qarkullimit të dokumenteve me nënshkrimin elektronik (SQDNE) janë paraqitur dhe trajtuar 2 aplikime të ardhura nga institucionet e tjera.

Agjencia e Trajtimit të Pronave në kuadër të procesit të implementimit të shërbimeve vetëm online, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”, prej datës 31 Dhjetor 2020 aplikimet sipas udhëzimeve institucionale për shërbimet e mëposhtme mundësohen **vetëm online, nëpërmjet portalit E-Albania:**

Evidencë e shkresave/kërkesave/ankesave qytetare të hyra dhe të trajtuara në ATP Janar- Dhjetor 2022

Emërtimi i kërkesave/ankesave qytetare në ATP	Numri
Nr. i shkresave qytetare nga protokollit	2165
Nr. i kërkesave nga sportelet marr. me publikun Janar-Mars	268
Nr. i masave për denoncime kundër korrupsionit	0
Nr. i ankesave nga portali i bashkëqeverisjes	139
Nr. i kërkesë/ankesave nga portali e-Albania	532

7. Analiza e Buxhetit dhe Fondeve Speciale të Kompensimit

7.1 Analiza e Buxhetit të vitit 2022 duke u bazuar në 12 mujor (i pa kuadruar nga dega e thesarit)

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Buxheti 2022	Buxheti 2022 #	Plani 12-Mujor	Fakti 12- Mujor
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	165,900,000	123,752,000	123,752,000	122,157,309
2	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore	601	27,700,000	21,008,000	21,008,000	20,385,100
3	Mallra dhe shërbime të tjera	602	55,400,000	27,438,000	27,438,000	21,633,767
4	Transferime Korrente të Brendshme	604	3,500,000,000	1,000,000,000	1,000,000,000	1,000,000,000
5	Transferta për Buxhetet Familjare (Fondi Veçantë)	606	200,000	1,422,000	1,422,000	1,390,000
6	Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Trupëzuara	231	6,000,000	5,600,000	5,600,000	5,505,960
7	Te ardhura nga Vkm të tjera				129,184	129,184.00
	Totali 1 (Shpenzime Buxhetore)		3,755,200,000	1,179,220,000	1,179,349,184	1,171,201,320
1	Te Ardhura Jashtë - Buxhetore		1,000,000,000	989,305,323	989,305,322.56	989,305,322.56
	Totali 2 (Jashtë- Buxhetore)		1,000,000,000	989,305,323	989,305,323	989,305,322.56
	TOTAL Buxhetore dhe Jashtë Buxhetore (Total 1+Total 2)		4,755,200,000	2,168,525,323	2,168,654,507	2,160,506,643.04

Në ATP, për shpenzimet e Buxhetit të Vitit 2022 rezulton:

- ▶ Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli - Realizim në masën 99%
- ▶ Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore - Realizimi në masën 97%
- ▶ Mallra dhe shërbime të tjera - Realizimi në masën 79%
Vlera prej 4,153,572 është në thesar në pritje për likuidim, për llogari të vitit 2022 e cila nuk është përfshirë te fakti në tabelë.
- ▶ Transferime Korrente të Brendshme - Realizuar në masën 100%
Fond në dispozicion të ATP-së ne BSH por i pa shpërndarë për arsye të pezullimit të Ligjit Nr. 133/2015.
- ▶ Transferta për Buxhetet Familjare Fond të Veçantë - Realizimi në masën 98%
- ▶ Shpenzime për Rritjen e Aktiveve të Trupëzuara
Si prokurim është realizuar në masën 100%, ndërsa fondet 98%. Kursimi nga prokurimi.

7.2 Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për vitin 2022

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	2,576,445.00	Periudha 12 Mujore
2	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099	-	Periudha 12 Mujore
3	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	7109901	-	Periudha 12 Mujore
4	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtshme e të truallit funksional të tyre	7109902	-	Periudha 12 Mujore
5	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	7109903	-	Periudha 12 Mujore
6	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terrene	1161110	129,184	Periudha 12 Mujore
7	Të tjera	7115499	75,000	Periudha 12 Mujore
8	Të ardhura nga transferimi i pronës nga Legalizimi i Ndërtimeve pa Leje 70%	7116101	850,215,191.81	Periudha 12 Mujore
9	Të ardhura nga Transferimi i pronës nga Legalizimi i Ndërtimeve pa Leje 50%	7116102	54,636,191.00	Periudha 12 Mujore
TOTAL			907,632,011.81	

Informacioni për të ardhurat është i pa kuadruar nga thesari: Tarifa për Aktet Administrative
Informacioni është 12 Mujor.

Totali 3+4+5+6+7	129,184	Të ardhura që i shtohen ATP-së në Fondin e Kompensimit, në pritje për kalimin nga thesari në Bankën e Shqipërisë (Rritje e Autorizuar).
Totali 8+9	904,851,382.81	Të ardhura që i shtohen ATP-së për Kompensimin e Pronarëve për tokat e zëna nga Ndërtimet Informale (Aluizni), për vitin 2022

Informacion i shpenzimeve për ALUIZNI, Kompensim me Raste të Veçanta dhe Kompensim Financiar.

Totali	1,248,387,093.57	Nr.Subjekteve/ Mbyllje Procedimi	
Xhirime Aluizni	553,856,429.85	244	
Kompensim Raste të Veçanta	694,530,663.72	209	3 vendime (dhënë 2 këste 2020/2021)
Kompensim Financiar	-	-	